

31998L0078

Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve

Gazeta Zyrtare L 330, 05/12/1998 fq. 0001-0012

DIREKTIVA 98/78/KE E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 57 paragrafi 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (1),

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2),

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 189b të Traktatit (3),

(1) Meqë direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datës 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë pa përfshirë sigurimin e jetës (4) dhe Direktiva e parë e Këshillit 79/267/KEE, datë 5 mars 1979, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë të jetës (5) u kërkojnë ndërmarrjeve të sigurimit të kenë nivelin e aftësisë pagueuse;

(2) Meqë, sipas Direktivës së Këshillit 92/49/KEE, datë 18 qershor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë pa përfshirë sigurimin e jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 73/239/KEE dhe 88/357/KEE (6) dhe Direktivës së Këshillit 92/96/KEE, datë 10 nëntor 1992, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë të jetës dhe për ndryshimin e Direktivave 79/267/KEE dhe 90/619/KEE (7) fillimi dhe ndjekja e veprimtarisë së sigurimeve i nënshtrohet dhënies së një autorizimi të unifikuar zyrtar të lëshuar nga autoritetet e Shtetit Anëtar ku ka selinë e regjistruar ndërmarrja e sigurimeve (Shteti Anëtar i origjinës); meqë ky autorizim i lejon ndërmarrjes të ushtrijë veprimtari në të gjithë Komunitetin, bazuar në të drejtën e vendosjes ose të lirisë për të ofruar shërbime; meqë autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare të origjinës janë përgjegjëse për monitorimin dhe gjendjen financiare të ndërmarrjeve të sigurimeve duke përfshirë aftësinë e tyre pagueuse;

(3) Meqë masat në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në një grup sigurimesh duhet t'u japin mundësi autoriteteve që mbikëqyrin ndërmarrjen e sigurimeve të

krijojnë një gjykim më të bazuar për gjendjen e saj financiare; meqë kjo mbikëqyrje financiare shtesë është mirë të marrë parasysh ndërmarrje të caktuara të cilat nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes sipas direktivave të Komunitetit; meqë kjo direktivë nuk nënkupton në asnjë mënyrë që Shteteve Anëtare u kërkohet të mbikëqyrin ndërmarrjet e lartpërmendura secilën prej veçmas;

(4) Meqë ndërmarrjet e sigurimeve në një treg të përbashkët sigurimesh përfshihen në konkurrencë të drejtpërdrejtë me njëra-tjetrën edhe rregullat në lidhje me kërkesat për kapitalin duhet të jenë të barasvlershme; meqë, për këtë qëllim, kriteret e zbatuara për të përcaktuar mbikëqyrjen shtesë nuk është mirë të lihen vetëm në gjykimin e Shteteve Anëtare; meqë miratimi i rregullave bazë të përbashkëta do të jetë në interesin e Komunitetit meqenëse do të parandalojë shtrembërimet e konkurrencës; meqë është i nevojshëm eliminimi i divergjencave të caktuara ndërmjet legjislacioneve të Shteteve Anëtare në lidhje me rregullat mbikëqyrëse të cilave u nënshtrohen ndërmarrjet e sigurimeve që janë pjesë e grupit të sigurimeve;

(5) Meqë qëndrimi i miratuar konsiston në realizimin e një harmonizimi që është thelbësor, i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për arritjen e njohjes së ndërsjellë të sistemeve të kontrollit mbikëqyrës në këtë fushë; meqë qëllimi i kësaj direktive është veçanërisht mbrojtja e interesave të personave të siguruar;

(6) Meqë dispozita të caktuara të kësaj direktive përcaktojnë standardet minimale; meqë Shteti Anëtar i origjinës mund të vendosë rregulla më rigorozë për ndërmarrjet e sigurimeve të autorizuara nga autoritetet e tij kompetente;

(7) Meqë kjo direktivë parashikon një mbikëqyrje shtesë të çdo shoqërie sigurimesh që është ndërmarrje pjesëmarrëse në të paktën një ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje ri-sigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar dhe, me rregulla të ndryshme, një mbikëqyrje shtesë të çdo shoqërie sigurimesh ndërmarrja mëmë e së cilës është shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh, ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar ose shoqëri holding sigurimesh me veprimtari të përzier; meqë mbikëqyrja e ndërmarrjeve individuale të sigurimeve nga autoritetet kompetente mbetet një parim thelbësor i mbikëqyrjes së sigurimeve;

(8) Meqë është e nevojshme të llogaritet niveli i rregulluar i aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve që janë pjesë e grupeve të sigurimeve; meqë zbatohen metoda të ndryshme nga autoritetet kompetente në Komunitet për të marrë parasysh efektet mbi gjendjen financiare të ndërmarrjes së sigurimeve që i atribuohen faktit se ajo i përket një grupi sigurimesh; meqë pranohet parimi që këto metoda janë të barasvlershme për mbikëqyrjen;

(9) Meqë aftësia paguese e ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve të kontrolluar nga një shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrjes së risigurimeve ose ndërmarrjes së sigurimeve të një vendi jo anëtar mund të ndikohet nga burimet financiare të grupit ku bën pjesë dhe nga shpërndarja e burimeve financiare brenda atij grupi; meqë është mirë të pajisen autoritetet kompetente me mënyrat për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë dhe për marrjen e masave të përshtatshme në

nivelin e ndërmarrjes së sigurimeve nëse është rrezikuar ose mund të rrezikohet aftësia paguese e saj;

(10) Meqë autoritetet kompetente është mirë të kenë të drejtën për të marrë informacionet e lidhura me ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë; meqë është mirë të vendoset bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve si dhe ndërmjet atyre autoriteteve dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e sektorëve të tjerë financiarë;

(11) Meqë transaksionet brenda grupit mund të ndikojnë në gjendjen financiare të ndërmarrjes së sigurimeve; meqë është mirë që autoritetet kompetente të jenë në gjendje të ushtrjnë mbikëqyrje të përgjithshme mbi lloje të caktuara të këtyre operacioneve brenda grupit dhe të marrin masat e përshtatshme për ndërmarrjen e sigurimeve nëse aftësia paguese është rrezikuar ose mund të rrezikohet,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) ndërmarrje sigurimi është ndërmarrja që ka marrë autorizimin zyrtar në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 6 të Direktivës 79/267/KEE;

(b) ndërmarrje sigurimi e një vendi jo anëtar është ndërmarrja së cilës do t'i kërkohej autorizim në përputhje me nenin 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 6 të Direktivës 79/267/KEE nëse do ta kishte selinë e regjistruar në Komunitet;

(c) ndërmarrje risigurimi është ndërmarrja që nuk është ndërmarrje sigurimi ose ndërmarrje sigurimi e një vendi jo anëtar, veprimtaria kryesore e së cilës konsiston në pranimin e risqeve të ceduara nga një ndërmarrje sigurimi ose ndërmarrje sigurimi e një vendi jo anëtar apo nga ndërmarrje të tjera risigurimi;

(d) ndërmarrje mëmë është ndërmarrja sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 83/349/KEE (8) dhe çdo ndërmarrje që, sipas mendimit të autoriteteve kompetente, ushtron efektivisht ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër;

(e) ndërmarrje filial është ndërmarrja e kontrolluar sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 83/349/KEE dhe çdo ndërmarrje mbi të cilën, sipas mendimit të autoriteteve kompetente, një ndërmarrje mëmë ushtron efektivisht ndikim dominues. Të gjitha filialet e ndërmarrjeve filiale konsiderohen gjithashtu filiale të ndërmarrjes mëmë që është në krye të atyre ndërmarrjeve;

(f) pjesëmarrje është pjesëmarrja sipas kuptimit të nenit 17, fjalia e parë, e Direktivës 78/660/KEE(9) ose zotërimi, drejtpërdrejt ose jo, i njëzet përqind ose më shumë të të drejtave të votimit ose kapitalit të një ndërmarrjeje;

(g) ndërmarrje pjesëmarrëse është ndërmarrja që është ndërmarrje mëmë ose një ndërmarrje tjetër që zotëron një pjesëmarrje;

(h) ndërmarrje e lidhur është ndërmarrja filial ose një ndërmarrje tjetër në të cilën zotërohet një pjesëmarrje;

(i) shoqëri holding sigurimi është ndërmarrja mëmë veprimtaria kryesore e së cilës është marrja në pronësi dhe zotërimi i pjesëmarrjeve në ndërmarrje filiale, ku këto ndërmarrje filiale janë ekskluzivisht ose kryesisht ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh të vendeve jo anëtare, ku të paktën njëra prej ndërmarrjeve filiale është ndërmarrje sigurimesh;

(j) shoqëri holding sigurimesh me veprimtari të përzier është shoqëria mëmë që nuk është ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar, ndërmarrje risigurimesh ose shoqëri sigurimesh holding dhe që ka të paktën një ndërmarrje sigurimesh në ndërmarrjet e saj filiale;

(k) autoritete kompetente janë autoritetet kombëtare që kanë kompetencë të dhënë me akt ligjor ose nënligjor për të mbikëqyrur ndërmarrjet e sigurimeve.

Neni 2

Rastet e zbatimit të mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve

1. Përveç dispozitave të Direktivave 73/239/KEE dhe 79/267/KEE të cilat vendosin rregullat për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve, Shtetet Anëtare sigurojnë që mbikëqyrja e çdo ndërmarrjeje të sigurimeve që është ndërmarrje pjesëmarrëse në të paktën një ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh të një vendi jo anëtar të plotësohet në mënyrën e parashikuar në nenet 5, 6, 8 dhe 9.

2. Çdo ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrja mëmë e së cilës është shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar, i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë në mënyrën e parashikuar në nenin 5 pika 2 dhe nenet 6, 8 dhe 10.

3. Çdo ndërmarrje sigurimesh, ndërmarrja mëmë e së cilës është shoqëri holding sigurimesh me veprimtari të përzier i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë në mënyrën e parashikuar në nenin 5 pika 2 dhe nenet 6 dhe 8.

Neni 3

Objekti i mbikëqyrjes shtesë

1. Ushtrimi i mbikëqyrjes shtesë në përputhje me nenin 2 në asnjë mënyrë nuk do të thotë që autoriteteve kompetente u kërkohet të luajnë një rol mbikëqyrës në lidhje me ndërmarrjet e sigurimeve të vendeve jo anëtare, shoqërive holding të sigurimeve ose shoqërive holding të sigurimit me veprimtari të përzier ose ndërmarrjeve të risigurimit të konsideruara në mënyrë individuale.

2. Mbikëqyrja shtesë merr parasysh:

- ndërmarrjet e lidhura të ndërmarrjeve të sigurimeve,
 - ndërmarrjet pjesëmarrëse në ndërmarrjet e sigurimeve,
 - ndërmarrjet e lidhura të ndërmarrjes pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve,
- të përmendura në nenet 5, 6, 8, 9 dhe 10.

3. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos marrin parasysh gjatë mbikëqyrjes shtesë të parashikuar në nenin 2 ndërmarrjet që e kanë selinë e regjistruar në një vend jo anëtar, nëse ka pengesa ligjore për transferimin e informacionit të nevojshëm, pa cenuar dispozitat e shtojcës I, pika 2 dhe 5, dhe shtojcës II, pika 4.

Për më tepër, autoritetet kompetente përgjegjëse për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë, në rastet e renditura më poshtë, mund të vendosin rast pas rasti për të mos e marrë parasysh ndërmarrjen për mbikëqyrjen shtesë të përmendur në nenin 2:

- nëse ndërmarrja që duhet të përfshihet është e një interesi të ulët në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimit,
- nëse përfshirja e gjendjes financiare të ndërmarrjes do të ishte e papërshtatshme ose keqorientuese në lidhje me objektivat e mbikëqyrjes shtesë të ndërmarrjeve të sigurimit.

Neni 4

Autoritetet kompetente për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë

1. Mbikëqyrja shtesë ushtrohet nga autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar në të cilin ndërmarrja e sigurimeve ka marrë autorizimin zyrtar sipas nenit 6 të Direktivës 73/239/KEE ose nenit 6 të Direktivës 79/267/EEC.
2. Nëse ndërmarrjet e sigurimeve të autorizuar në një ose më shumë Shtete Anëtare kanë si ndërmarrje mëmë të njëjtën shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh, ndërmarrje sigurimesh të një vendi jo anëtar ose një shoqëri sigurimesh holding me veprimtari të përzier, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse mund të arrijnë marrëveshje se cili prej tyre do të jetë përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë.
3. Nëse një Shtet Anëtar ka më shumë se një autoritet kompetent për mbikëqyrjen financiare të ndërmarrjeve të sigurimeve dhe ndërmarrjeve të risigurimeve, ky Shtet Anëtar merr masat e nevojshme për të organizuar bashkërendimin ndërmjet atyre autoriteteve.

Neni 5

Disponibiliteti dhe cilësia e informacionit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet kompetente të kërkojnë që çdo ndërmarrje sigurimesh që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë të ketë mekanizma të mjaftueshme kontrolli

të brendshëm për nxjerrjen e të dhënave dhe informacionit për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje shtesë.

2. Shtetet Anëtare ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që të mos ketë pengesa ligjore brenda juridiksionit të tyre për ndërmarrjet të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes shtesë dhe ndërmarrjet e tyre të lidhura dhe ndërmarrjet e tyre pjesëmarrëse të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacionin përkatës për qëllimet e kësaj mbikëqyrjeje shtesë.

Neni 6

E drejta e shikimit të informacionit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet e tyre kompetente përgjegjëse për ushtrimin e mbikëqyrjes shtesë të ketë të drejtë të marrjes së çdo informacioni që do të ishte i rëndësishëm për qëllimin e mbikëqyrjes së ndërmarrjes së sigurimeve që i nënshtrohet kësaj mbikëqyrjeje shtesë. Autoritetet kompetente mund t'u drejtohen drejtpërdrejt ndërmarrjeve përkatëse të përmendura në nenin 3 pika 2 për të marrë informacionin e nevojshëm vetëm nëse ky informacion i është kërkuar ndërmarrjes së sigurimeve dhe nuk është dhënë prej saj.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet e tyre kompetente mund të kryejnë brenda territorit të tyre, vetë ose me ndërmjetësimin e personave të cilët ata i emërojnë për këtë qëllim, verifikime në vend të informacionit të përmendur në pikën 1 tek:

- ndërmarrja e sigurimeve që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë,
- ndërmarrjet filiale të asaj ndërmarrjeje sigurimesh,
- ndërmarrjet mëmë të asaj ndërmarrjeje sigurimesh,
- ndërmarrjet filiale të një ndërmarrjeje mëmë të asaj ndërmarrjeje sigurimesh.

3. Nëse, në zbatimin e këtij neni, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar dëshirojnë të verifikojnë në raste të veçanta informacione të rëndësishme në lidhje me ndërmarrjen e ndodhur në një Shtet Anëtar tjetër e cila është ndërmarrje sigurimi e lidhur, ndërmarrje filial, ndërmarrje mëmë ose filial i ndërmarrjes mëmë të ndërmarrjes së sigurimeve që i nënshtrohet mbikëqyrjes shtesë, ato duhet t'u kërkojnë autoriteteve të Shtetit Anëtar tjetër që të kryejnë verifikimin në fjalë. Autoritetet që marrin një kërkesë të tillë duhet të veprojnë brenda kufijve të juridiksionit të tyre duke e kryer vetë verifikimin, duke u lejuar autoriteteve që kanë bërë kërkesën ta kryejnë atë ose duke lejuar një auditues ose ekspert ta kryejë atë.

Neni 7

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente

1. Nëse ndërmarrjet e sigurimeve të vendosura në Shtete të ndryshme Anëtare janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi ose kanë një ndërmarrje të përbashkët pjesëmarrëse, autoritetet kompetente të secilit Shtet Anëtar i komunikojnë me kërkesë njëri-tjetrit të gjitha informacionet përkatëse që mund të mundësojnë ose lehtësojnë ushtrimin e mbikëqyrjes në

përputhje me këtë direktivë dhe komunikojnë kryesisht çdo informacion që atyre u duket thelbësor për autoritetet e tjera kompetente.

2. Nëse një ndërmarrje sigurimesh dhe një institucion krediti sipas përkufizimit në Direktivën 77/780/KEE(10) ose një firmë investimesh sipas përkufizimit të Direktivës 93/22/KEE (11) ose të dyja bashkë, janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi ose kanë një ndërmarrje pjesëmarrëse të përbashkët, autoritetet kompetente dhe autoritetet me përgjegjësi publike për mbikëqyrjen e këtyre ndërmarrjeve bashkëpunojnë ngushtë. Pa cenuar përgjegjësitë e tyre përkatëse, këto autoritete i japin njëri-tjetrit çdo informacion që mund të lehtësojë punën e tyre, veçanërisht brenda kuadrit të kësaj direktive.

3. Informacioni i marrë në përputhje me këtë direktivë dhe, veçanërisht, çdo shkëmbim informacioni ndërmjet autoriteteve kompetente i cili është i parashikuar në këtë direktivë i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional të përkufizuar në nenin 16 të Direktivës 92/49/KEE dhe nenin 15 të Direktivës 92/96/KEE.

Neni 8

Transaksionet brenda grupit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që autoritetet kompetente të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme mbi transaksionet ndërmjet:

(a) një ndërmarrjeje sigurimesh dhe:

(i) një ndërmarrjeje të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve,

(ii) një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve,

(iii) një ndërmarrjeje të lidhur të një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve,

(b) një ndërmarrjeje sigurimesh dhe një personi fizik që ka pjesëmarrje në:

(i) ndërmarrjen e sigurimeve ose një prej ndërmarrjeve të lidhura të saj;

(ii) një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve;

(iii) një ndërmarrjeje të lidhur të një ndërmarrjeje pjesëmarrëse në ndërmarrjen e sigurimeve.

Këto transaksione kanë të bëjnë veçanërisht me:

- huatë,

- garancitë dhe veprimet jashtë bilancit,

- elementët e përshtatshëm për nivelin e aftësisë paguese,

- investimet,

- operacionet risiguruese,

- marrëveshjet për ndarjen e kostove.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare kërkojnë të paktën një raportim mujor nga ndërmarrjet e sigurimeve tek autoritetet kompetente mbi transaksionet e rëndësishme të parashikuara në pikën 1.

Nëse, në bazë të këtij informacioni, duket se aftësia paguese e ndërmarrjes së sigurimeve rrezikohet ose mund të rrezikohet, autoriteti kompetent merr masat e përshtatshme në nivelin e ndërmarrjes së sigurimeve.

Neni 9

Kërkesa për aftësinë e rregulluar paguese

1. Në rastin e përmendur në nenin 2 pika 1, Shtetet Anëtare kërkojnë që të kryhet një përlllogaritje e aftësisë paguese të rregulluar në përputhje me shtojcën I.

2. Në llogaritjen e përmendur në pikën 1 përfshihet çdo ndërmarrje e lidhur, ndërmarrje pjesëmarrëse ose ndërmarrje e lidhur e një ndërmarrjeje pjesëmarrëse .

3. Nëse llogaritja e përmendur në pikën 1 tregon që aftësia paguese e rregulluar është negative, autoritetet kompetente marrin të gjitha masat e përshtatshme për ndërmarrjen në fjalë.

Neni 10

Ndërmarrjet e risigurimeve, shoqëritë holding të sigurimeve dhe ndërmarrjet e sigurimeve të vendeve jo anëtare

1. Në rastin e përmendur në nenin 2 pika 2, Shtetet Anëtare kërkojnë që metoda e mbikëqyrjes shtesë të zbatohet në përputhje me shtojcën I.

2. Në rastin e përmendur në nenin 2 pika 2, llogaritja përfshin të gjitha ndërmarrjet e lidhura të shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjen e risigurimit ose ndërmarrjen e sigurimeve të vendit jo anëtar, në mënyrën e parashikuar në shtojcën II.

3. Nëse në bazë të kësaj llogaritjeje, autoritetet kompetente nxjerrin përfundimin që aftësia paguese e një ndërmarrjeje sigurimesh filial i shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së risigurimeve ose ndërmarrjes së sigurimeve të një vendi jo anëtar rrezikohet ose mund të rrezikohet, ato marrin masat e përshtatshme në nivelin e asaj ndërmarrjeje të sigurimeve.

Neni 11

Zbatimi

1. Shtetet Anëtare miratojnë aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të nevojshme për zbatimin e kësaj direktive jo më vonë se data 5 qershor 2000. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë që dispozitat e përmendura në pikën 1 të zbatohen fillimisht për mbikëqyrjen e llogarive për vitet financiare që fillojnë më 1 janar 2001 ose gjatë atij viti kalendarik.

3. Shtetet Anëtare, në rastet kur miratojnë masat e përmendura në pikën 1, përfshijnë një tekst referues që bën lidhjen me këtë direktivë ose i shoqërojnë ato me një tekst të tillë referues kur t'i botojnë zyrtarisht. Mënyrat e përfshirjes së një teksti të tillë referues përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

4. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat kryesore të legjislacionit të brendshëm që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

5. Jo më vonë se data 1 janar 2006, Komisioni i paraqet Komitetit të Sigurimeve një raport mbi zbatimin e kësaj direktive dhe, sipas rastit, mbi nevojën për harmonizim të mëtejshëm.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Neni 13

Të adresuarit

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Bërë në Luksemburg, më 27 tetor 1998.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

J. M. GIL-ROBLES

Për Këshillin

Presidenti

E. HOSTASCH

[1] GZ C 341, 19.12.1995, fq. 16 dhe GZ C 108, 7.4.1998, fq. 48.

[2] GZ C 174, 17.6.1996, fq. 16.

[3] Opinioni i Parlamentit Europian, datë 23 tetor 1997 (GZ C 339, 10.11.1997, fq. 136), Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit, datë 30 mars 1998 (GZ C 204, 30.6.1998, fq. 1), Vendim i Parlamentit Europian, datë 16 shtator 1998 (GZ C 313, 12.10.1998) dhe Vendimi i Këshillit, datë 13 tetor 1998.

[4] GZ L 228, 16.8.1973, f. 3. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga direktiva 95/26/KE (GZ L 168, 18.7.1995, fq. 7).

[5] GZ L 63, 13.3.1979, f. 1. Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga direktiva 95/26/KE.

[6] GZ L 228, 11.8.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 95/26/KE.

[7] GZ L 360, 9.12.1992, fq. 1. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 95/26/KE.

(8) Direktiva e Shtatë e Këshillit 83/349/KEE, datë 13 qershor 1983, mbështetur në nenin 54 paragrafi 3 germa g të Traktatit për llogaritë e konsoliduara (GZ L 193, 18.07.1983, fq. 1). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Akti i Aderimit i vitit 1994.

(9) Direktiva e Katërt e Këshillit 78/660/KEE, datë 25 korrik 1978, mbështetur në nenin 54 paragrafi 3 germa g të Traktatit për llogaritë vjetore të disa llojeve të caktuara të shoqërive tregtare (GZ L 222, 18.07.1978, fq. 11). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Akti i Aderimit i vitit 1994.

(10) Direktiva e Parë e Këshillit 77/780/KEE, datë 12 dhjetor 1977, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së institucioneve të kreditit (GZ L 322, 17.12.1977, fq. 30). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 96/13/KE (GZ L 66, 16.3.1996, fq. 15).

(11) Direktivë e Këshillit 93/22/KEE, datë 10 maj 1993, për shërbimet e investimeve në letra me vlerë (GZ L 141, 11.6.1993, fq. 27). Direktivë e ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva 97/9/KE (GZ L 84, 26.3.1997, fq. 22).

SHTOJCA I

LLOGARITJA E AFTËSISË SË RREGULLUAR PAGUESE TË NDËRMARRJEVE TË SIGURIMEVE

1. ZGJEDHJA E METODËS SË LLOGARITJES DHE PARIMET E PËRGJITHSHME

A. Shtetet Anëtare parashikojnë që llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve e përmendur në nenin 2 pika 1 të kryhet në përputhje me një prej metodave të përshkruara në pikën 3. Megjithatë, Shteti Anëtar mund të parashikojë që autoritetet kompetente të autorizojnë ose të vendosin zbatimin e një metode të caktuar në pikën 3 përveç asaj që është zgjedhur nga Shteti Anëtar.

B. Proporcionaliteti

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese së ndërmarrjes së sigurimeve merr parasysh pjesën proporcionale që ndërmarrja pjesëmarrëse ka në ndërmarrjet e saj të lidhura.

“Pjesa proporcionale” është, nëse përdoret metoda 1 ose metoda 2 e përshkruar në pikën 3, raporti i kapitalit të nënshkruar që zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi ndërmarrja pjesëmarrëse ose, nëse përdoret metoda 3 e përshkruar në pikën 3, përqindjet e përdorura për përpilimin e llogarive përfundimtare.

Megjithatë, cilado qoftë metoda e përdorur, nëse ndërmarrja e lidhur është një ndërmarrje filial dhe ka një deficit në aftësinë paguese, në konsideratë duhet të merret deficiti i aftësisë paguese totale të filialit.

Megjithatë, nëse sipas mendimit të autoriteteve kompetente përgjegjësia e ndërmarrjes mëmë që ka në pronësi një pjesë të kapitalit është e kufizuar rigorozisht dhe qartë tek ajo pjesë e kapitalit, këto autoritete kompetente mund të japin leje që deficiti i aftësisë paguese të ndërmarrjes filial të merret parasysh në mënyrë proporcionale.

C. Eliminimi i përdorimit të dyfishtë të elementëve të nivelit të aftësisë paguese

C.1. Trajtimi i përgjithshëm i elementëve të nivelit të aftësisë paguese

Pavarësisht nga metoda e përdorur për llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh, duhet të përjashtohet përdorimi i dyfishtë i elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese ndërmjet ndërmarrjeve të ndryshme të sigurimeve të përfshira në këtë llogaritje.

Për këtë qëllim, shumat e mëposhtme përjashtohen gjatë llogaritjes së aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve nëse metodat e përshkruara në pikën 3 nuk e parashikojnë atë:

- vlera e çdo aktivi të ndërmarrjes së sigurimeve që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të një prej ndërmarrjeve të sigurimeve të lidhura të saj,
- vlera e çdo aktivi të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të asaj ndërmarrjeje sigurimesh,
- vlera e çdo aktivi të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve që përfaqëson financimin e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të çdo ndërmarrjeje tjetër sigurimesh të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh.

C.2. Trajtimi i disa elementëve të caktuar

Pa cenuar dispozitat e seksionit C.1:

- rezervat e fitimeve dhe fitimet e ardhshme në një ndërmarrjeje të sigurimit të jetës të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve për të cilën llogaritet aftësia e rregulluar paguese dhe,
- kapitali i nënshkruar por i papaguar paraprakisht i një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve për të cilën llogaritet aftësia paguese e rregulluar

mund të përfshihet në llogaritje vetëm për aq sa janë të lejuara për mbulimin e kërkesës për nivelin e aftësisë paguese të asaj ndërmarrjeje të lidhur. Megjithatë, kapitali i nënshkruar por i papaguar paraprakisht që përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e ndërmarrjes pjesëmarrëse përjashtohet tërësisht nga llogaritja.

Kapitali i nënshkruar por i papaguar paraprakisht i ndërmarrjes së sigurimeve pjesëmarrëse që përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur përjashtohet gjithashtu nga llogaritja.

Kapitali i nënshkruar por i papaguar paraprakisht i ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur që përfaqëson një detyrim të mundshëm nga ana e një ndërmarrjeje tjetër të sigurimeve të lidhur të së njëjtës ndërmarrjeje të sigurimeve pjesëmarrëse përjashtohet nga llogaritja.

C.3. Transferueshmëria

Nëse autoritetet kompetente konsiderojnë që elementë të caktuar e të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur, pa përfshirë ato të përmendura në seksionin C.2, nuk mund të ofrohen në mënyrë të efektshme për të mbuluar kërkesën e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve pjesëmarrëse për të cilën llogaritet aftësia paguese e rregulluar, këto elemente mund të përfshihen në llogaritje vetëm për atë sa lejohen për mbulimin e kërkesës së nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur.

C.4. Shuma e elementeve të përmendura në seksionet C.2 dhe C.3 nuk mund të jetë më e madhe se kërkesa për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së sigurimeve të lidhur.

D. Eliminimi i krijimit të kapitalit brenda grupit

Në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese, nuk merret parasysh asnjë element i lejuar për nivelin e aftësisë paguese që rrjedh nga financimi reciprok ndërmjet ndërmarrjes së sigurimeve dhe:

- një ndërmarrjeje të lidhur,
- një ndërmarrjeje pjesëmarrëse,
- një ndërmarrjeje tjetër të lidhur të ndërmarrjeve të saj pjesëmarrëse.

Për më tepër, nuk merret parasysh asnjë element i lejuar për nivelin e aftësisë paguese të një ndërmarrjeje sigurimesh të lidhur të ndërmarrjes së sigurimeve për të cilën llogaritet aftësia e rregulluar paguese llogaritet kur elementi në fjalë del nga financimi reciprok me çdo ndërmarrje tjetër të lidhur të asaj ndërmarrjeje sigurimesh.

Veçanërisht, financimi reciprok ekziston nëse ndërmarrja e sigurimeve ose një prej ndërmarrjeve të saj të lidhura zotëron aksione të një ndërmarrjeje tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron një element të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së parë, ose i jep hua kësaj ndërmarrjeje tjetër.

E. Autoritetet kompetente sigurojnë që aftësia paguese e rregulluar të llogaritet me të njëjtën shpeshësi siç është parashikuar në Direktivën 73/239/KEE dhe 79/267/KEE për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve. Vlera e aktiveve dhe pasiveve vlerësohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Direktivave 73/239/KEE, 79/267/KEE dhe 91/674/KEE(1).

2. ZBATIMI I METODAVE TË LLOGARITJES

2.1. Ndërmarrjet e lidhura të sigurimeve

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese kryhet në përputhje me parimet dhe metodat e përgjithshme të parashikuara në këtë shtojcë.

Në rastin e të gjithë metodave, kur ndërmarrja e sigurimeve ka më shumë se një ndërmarrje të lidhur sigurimesh, llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese kryhet duke integruar secilën prej këtyre ndërmarrjeve të lidhura të sigurimeve.

Në rastin e pjesëmarrjeve të njëpasnjëshme (për shembull, kur një ndërmarrje sigurimesh është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje tjetër sigurimesh, e cila është gjithashtu ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje sigurimesh) llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese kryhet në nivelin e secilës ndërmarrjeje sigurimesh pjesëmarrëse që ka të paktën një ndërmarrje sigurimesh të lidhur.

Shtetet Anëtare mund të heqin dorë nga llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve:

- nëse ndërmarrja është ndërmarrje e lidhur e një ndërmarrje tjetër sigurimesh e autorizuar në të njëjtin Shtet Anëtar dhe kjo ndërmarrje e lidhur merret parasysh në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve pjesëmarrëse, ose

- nëse ndërmarrja e sigurimeve është ndërmarrje e lidhur me një shoqëri holding sigurimesh ose me një ndërmarrje risigurimesh që ka selinë e saj në të njëjtin Shtet Anëtar si ndërmarrja e sigurimeve dhe, si shoqëria holding e sigurimeve ashtu edhe ndërmarrja e risigurimeve dhe ndërmarrja e lidhur e sigurimeve, merren parasysh në llogaritjen e kryer.

Shtetet Anëtare mund të heqin gjithashtu dorë nga llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve nëse ajo është ndërmarrje sigurimesh e lidhur e një ndërmarrjeje tjetër sigurimesh, e një ndërmarrjeje risigurimesh ose një shoqërie holding sigurimesh që ka zyrën e saj të regjistruar në një Shtet tjetër Anëtar dhe nëse autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përkatëse kanë rënë dakord t'ia ngarkojnë mbikëqyrjen shtesë autoritetit kompetent të Shtetit të fundit Anëtar.

Në çdo rast, heqja dorë mund të lejohet vetëm nëse autoritetet kompetente janë të bindura që elementet e lejuara për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve të përfshira në llogaritje janë të shpërndara në mënyrë të përshtatshme ndërmjet tyre.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që nëse ndërmarrja e lidhur e sigurimeve e ka selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar që nuk është Shteti Anëtar i ndërmarrjes së sigurimeve për të cilën kryhet llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese, llogaritja, në lidhje me ndërmarrjen e lidhur, merr parasysh gjendjen e aftësisë paguese që vlerësohet nga autoritetet kompetente të Shtetit tjetër Anëtar.

2.2. Ndërmarrjet e lidhura të risigurimeve

Në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve që është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje risigurimesh, kjo ndërmarrje e lidhur risigurimesh trajtohet, vetëm për qëllimet e llogaritjes, në mënyrë të ngjashme me një ndërmarrje të lidhur sigurimesh, që zbaton parimet dhe metodat e përgjithshme të përshkruara në këtë Shtojcë.

Për këtë qëllim, vendoset një kërkesë për aftësinë paguese nocionale të çdo ndërmarrjeje të lidhur risigurimesh mbi bazën e të njëjtave rregulla që parashikohen në nenin 16 pikat nga 2 deri 5 të Direktivës 73/239/KEE ose nenin 19 të Direktivës 79/267/KEE. Megjithatë, në rastin e vështirësive të mëdha në zbatimin e këtyre rregullave, autoritetet kompetente mund të lejojnë që kërkesa e aftësisë paguese nocionale të sigurimit të jetës të llogaritet mbi bazën e rezultatit të parë sipas parashikimit të nenit 16 pika 3 të Direktivës 73/239/KEE. Të njëjtët elementë që gjenden në nenin 16 pika 1 të Direktivës 73/239/KEE dhe në nenin 18 të Direktivës 79/267/KEE njihen si të lejuar për nivelin e aftësisë paguese nocionale. Vlera e aktiveve dhe pasiveve vlerësohet në përputhje me të njëjtat rregulla siç janë parashikuar në ato direktiva dhe në Direktivën 91/674/KEE.

2.3. Shoqëritë holding të ndërmjetme të sigurimeve

Në llogaritjen e aftësisë së pastër paguese të ndërmarrjes së sigurimeve që ka pjesëmarrje në një ndërmarrje sigurimesh, një ndërmarrje të lidhur risigurimesh, ose një ndërmarrje sigurimesh në një shtet joanëtar nëpërmjet një shoqërie holding sigurimesh, merret parasysh gjendja e shoqërisë holding të ndërmjetme të sigurimeve. Për qëllimin e kësaj llogaritjeje që duhet të ndërmerret në përputhje me parimet dhe metodat e përgjithshme të përshkruara në këtë Shtojcë, kjo shoqëri holding sigurimesh trajtohet sikur të ishte një ndërmarrje sigurimesh që i nënshtrohet kërkesës për aftësi paguese zero dhe sikur t'u nënshtrohej të njëjtave kushte që parashikohen në nenin 16 pika 1 të Direktivës 73/239/KEE ose në nenin 18 të Direktivës 79/267/KEE në lidhje me elementët e lejuar për nivelin e aftësisë paguese.

2.4. Ndërmarrjet e lidhura të sigurimeve dhe risigurimit me seli në vende jo anëtare

A. Ndërmarrjet e lidhura të sigurimeve të vendeve jo anëtare

Në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve që është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje sigurimesh të një vendi jo anëtar, kjo e fundit trajtohet, vetëm për qëllimet e llogaritjes, në mënyrë të ngjashme me një ndërmarrje të lidhur sigurimesh, duke zbatuar parimet dhe metodat e përgjithshme të përshkruara në këtë Shtojcë.

Megjithatë, nëse vendi jo anëtar ku ka selinë e regjistruar kjo ndërmarrje ia nënshton këtë ndërmarrje kërkesës për të marrë autorizim dhe vendos mbi të një kërkesë aftësie paguese të paktën të krahasueshme me atë të parashikuar në Direktivat 73/239/KEE ose 79/267/KEE, duke marrë parasysh elementët e mbulimit të kësaj kërkesë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që llogaritja të marrë parasysh, në lidhje me këtë ndërmarrje, kërkesën e aftësisë paguese dhe elementët e lejuar për ta përmbushur këtë kërkesë sipas parashikimit nga vendi jo-anëtar në fjalë.

B. Ndërmarrjet e lidhura të risigurimeve të vendeve jo anëtare

Pavarësisht seksionit 2.2, në llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve që është ndërmarrje pjesëmarrëse në një ndërmarrje risigurimesh me seli të regjistruar në një vend jo anëtar, e cila u nënshtrohet të njëjtave kushte me ato të parashikuara në pikën A më sipër, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që llogaritja të marrë parasysh, në lidhje me ndërmarrjen e fundit, kërkesën për fondet e veta dhe elementët e lejuar për të përmbushur kërkesën e parashikuar nga vendi jo anëtar në fjalë. Nëse vetëm ndërmarrjet e sigurimeve të këtij vendi jo anëtar u nënshtrohen këtyre dispozitave, kërkesa për fondet e veta nacionale për ndërmarrjen e lidhur të risigurimeve dhe elementët e lejuar për të përmbushur kërkesën nacionale mund të llogaritet sikur ndërmarrja në fjalë të ishte një ndërmarrje e lidhur sigurimesh e këtij vendi jo anëtar.

2.5. Mospasja e informacionit të nevojshëm

Nëse, për çfarëdo lloj arsyeje, autoritetet kompetente nuk mund të marrin informacionet e nevojshme për llogaritjen e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes së sigurimeve, në lidhje me një ndërmarrje të lidhur me seli të regjistruar në një Shtet Anëtar ose në një vend jo anëtar, vlera e regjistrit të asaj ndërmarrjeje në ndërmarrjen pjesëmarrëse të sigurimeve zbritet nga elementët e lejuar për nivelin e aftësisë së rregulluar paguese. Në këtë rast, fitimet e pakonvertuara në lidhje me këtë pjesëmarrje nuk lejohet si një element i lejuar për nivelin e aftësisë së rregulluar paguese.

3. METODAT E LLOGARITJES

Metoda 1: Metoda e zbritjes dhe e mbledhjes

Gjendja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve është diferenca ndërmjet:

(i) shumës së:

(a) elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve dhe

(b) pjesës proporcionale të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve në elementët e lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeveDhe,

(ii) shumës së:

(a) vlerës së regjistrit të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve në ndërmarrjen pjesëmarrëse të sigurimeve dhe

(b) kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve dhe

(c) pjesës proporcionale të kërkesës për aftësi paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve.

Kur pjesëmarrja në ndërmarrjen e lidhur të sigurimeve konsiston, tërësisht ose pjesërisht, në pronësi të tërthortë, nënpika ii germa “a” përfshin vlerën e kësaj pronësie jo të drejtpërdrejtë, duke marrë parasysh interesat përkatës pasues; dhe nënpikën i germa “b” dhe nënpikën ii “c”

përfshijnë pjesët përkatëse proporcionale, përkatësisht të elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve dhe të kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve.

Metoda 2: Metoda e zbritjes së kërkesës

Aftësia e rregulluar paguese e ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve është diferenca ndërmjet:

(i) shumës së elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve

dhe

(ii) shumës së:

(a) kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve dhe

(b) pjesës proporcionale të kërkesës për aftësi paguese të ndërmarrjes së lidhur të sigurimeve.

Gjatë vlerësimit të elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese, pjesëmarrjet sipas kuptimit të kësaj Direktive vlerësohen me metodën e kapitalit neto, në përputhje me opsionin e parashikuar në nenin 59 pika 2 germa “b” të Direktivës 78/660/KEE.

Metoda 3: Metoda e bazuar në konsolidimin e llogarive

Llogaritja e aftësisë së rregulluar paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve kryhet mbi bazën e llogarive të konsoliduara. Aftësia e rregulluar paguese e ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve është diferenca ndërmjet:

elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese të llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara dhe

(a) ose shumës së kërkesës së aftësisë paguese të ndërmarrjes pjesëmarrëse të sigurimeve dhe të pjesëve proporcionale të kërkesave të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të lidhura të sigurimeve, bazuar në përqindjet e përdorura për krijimin e llogarive të konsoliduara

(b) ose kërkesës së aftësisë paguese të llogaritur mbi bazën e të dhënave të konsoliduara.

Dispozitat e Direktivave 73/239/KEE, 79/267/KEE dhe 91/674/KEE zbatohen për llogaritjen e elementëve të lejuar për nivelin e aftësisë paguese dhe të kërkesës së aftësisë paguese bazuar mbi të dhënat e konsoliduara.

(1) Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 nëntor 1991, për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve (GZ L 374, 31.12.1991, fq. 7).

SHTOJCA II

MBIKËQYJA SHITESË E NDËRMARRJEVE TË SIGURIMEVE QË JANË FILIALE TË NJË SHOQËRIE HOLDING SIGURIMESH, NJË NDËRMARRJEJE RISIGURIMESH OSE NJË NDËRMARRJEJE SIGURIMESH TË NJË VENDI JO ANËTAR

1. Në rastin kur dy ose më shumë ndërmarrje sigurimesh të përmendura në nenin 2 pika 2 të cilat janë filiale të një ndërmarrjeje holding sigurimesh, një ndërmarrjeje risigurimesh ose një ndërmarrjeje sigurimesh të një vendi jo anëtar dhe që janë vendosur në Shtete të ndryshme Anëtare, autoritetet kompetente sigurojnë që metodat e përkrahura në këtë shtojcë të zbatohen në mënyrë uniforme.

Autoritetet kompetente e ushtrojnë mbikëqyrjen shitesë me të njëjtën shpeshhtësi siç është parashikuar në Direktivat 73/239/KEE dhe 79/267/KEE për llogaritjen e nivelit të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të sigurimeve.

2. Shtetet Anëtare mund të heqin dorë nga llogaritja e parashikuar në këtë shtojcë në lidhje me ndërmarrjen e sigurimeve:

- nëse ndërmarrja e sigurimeve është një ndërmarrje e lidhur e një ndërmarrje tjetër sigurimesh dhe nëse merret parasysh në llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë që kryhet për ndërmarrjen tjetër,

- nëse kjo ndërmarrje sigurimesh dhe një ose më shumë ndërmarrje të tjera sigurimesh të autorizuara në të njëjtin Shtet Anëtar kanë si ndërmarrje të tyre mëmë të njëjtën shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh të një shteti të tretë dhe ndërmarrja e sigurimeve merret parasysh në llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë që kryhet për një prej këtyre ndërmarrjeve të tjera,

- nëse kjo ndërmarrje sigurimesh dhe një ose më shumë ndërmarrje të tjera sigurimesh të autorizuara në Shtete të tjerë Anëtare kanë si ndërmarrje të tyre mëmë të njëjtën shoqëri holding sigurimesh, ndërmarrje risigurimesh ose ndërmarrje sigurimesh të një shteti jo anëtar dhe një marrëveshje që lejon ushtrimin e mbikëqyrjes shitesë që mbulohet nga kjo shtojcë nga autoriteti mbikëqyrës i një Shteti tjetër Anëtar është lidhur në përputhje me nenin 4 pika 2.

Në rastin e pjesëmarrjeve të njëpasnjëshme (për shembull: një shoqëri holding sigurimesh ose një ndërmarrje risigurimesh që është vetë në pronësi të një shoqërie tjetër holding sigurimesh, një ndërmarrjeje risigurimesh ose një ndërmarrjeje sigurimesh të një vendi jo anëtar), Shtetet Anëtare mund të zbatojnë llogaritjet e parashikuara në këtë shtojcë vetëm në nivelin e ndërmarrjes më të lartë mëmë të ndërmarrjes së sigurimeve që është një shoqëri holding sigurimesh, një ndërmarrje risigurimesh ose një ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që të kryhen llogaritjet e ngjashme me ato të përkrahura në shtojcën I për shoqërinë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së risigurimeve dhe të ndërmarrjes së sigurimeve të një vendi jo anëtar.

Analogjia konsiston në zbatimin e parimeve dhe metodave të përgjithshme të përkrahura në shtojcën I në nivelin e shoqërisë holding të sigurimeve, ndërmarrjes së risigurimeve ose ndërmarrjes së sigurimeve të një vendi jo anëtar.

Për qëllimin e vetëm të kësaj llogaritjeje, ndërmarrja mëmë trajtohet sikur të ishte një ndërmarrje sigurimesh që i nënshtrohet:

- kërkesës për aftësi paguese zero, nëse është shoqëri holding sigurimesh,
- kërkesës për aftësi paguese nacionale sipas parashikimit në seksionin 2.2 të shtojcës I, nëse është një ndërmarrje risigurimesh, ose sipas parashikimit në seksionin 2.4 pika B të shtojcës I nëse është një ndërmarrje risigurimesh me seli në një vend jo anëtar,
- kërkesës për aftësi paguese të përcaktuar në përputhje me parimet e seksionit 2.4 germa “a” të shtojcës I, nëse është një ndërmarrje sigurimesh e një vendi jo anëtar,

dhe u nënshtrohet të njëjtave kushte që parashikohen në nenin 16 pika 1 të Direktivës 73/239/KEE dhe në nenin 18 të Direktivës 79/267/KEE në lidhje me elementët e lejuar për nivelin e aftësisë paguese.

4. Mospasja e informacionit të nevojshëm

Nëse, për çfarëdo lloj arsyeje, autoritetet kompetente nuk mund të marrin informacionet e nevojshme për llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë, në lidhje me një ndërmarrje të lidhur me seli të regjistruar në një Shtet Anëtar ose në një vend jo anëtar, vlera e regjistrit të asaj ndërmarrjeje në ndërmarrjen pjesëmarrëse zbritet nga elementët e lejuar për llogaritjen e parashikuar në këtë shtojcë. Në këtë rast, fitimet e pakonvertuara në lidhje me këtë pjesëmarrje nuk lejohen si element i lejuar për llogaritjen.